



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 28.02.2023

Nr: 16

Ora: 12:30

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE NR. 05 DHE NR. 08, DATË 17.02.2023 TË KOMISIONERIT  
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 28.02.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Koli BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

**OBJEKT:** Vendorsja e sanksionit administrativ ndaj znj. Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës;

**BAZË LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

## Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kuadër të procedurave për mbikëqyrjen e procesit të raportimeve për veprimtaritë publike të institucioneve shtetërore, ka konstatuar se nga ana e Bashkisë Durrës janë kryer një numër raportimesh në një afat më të ngushtë se afati minimal ligjor prej 5 ditësh, që përcakton pika 2 e nenit 92 të Kodit Zgjedhor.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj znj. Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës, i cili është personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për institucionin Bashkia Durrës.
3. Në përfundim të hetimit administrativ për periudhën e monitorimit 20 janar deri në 23 janar 2023, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se 2 raportime janë kryer përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, dhe me kërkesen nr. 05, dt. 17.02.2023 ka kërkuar në KAS vendosjen e masës administrative gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë. Në përfundim të hetimit administrativ për periudhën e monitorimit 24 janar deri në 2 shkurt 2023, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se 6 nga 19 raportime janë kryer përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, dhe me kërkesen nr. 08, dt. 17.02.2023 ka kërkuar në KAS vendosjen e masës administrative gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
4. KAS, në datën 27.02.2023, me vendimet nr. 8 dhe nr. 11, vendosi të kalojë për shqyrtim dy kërkesat e paraqitura në KQZ në datën 17.02.2023. Relatorët e kërkesave ankimore përkatësisht z. Koli Bele dhe z. Elvis Çefa kakonstatuan se të dy kërkesat kishin të njëjtin objekt dhe për këtë arsye vendosi bashkimin e kërkesave nr. 5 dhe nr. 8 dhe caktoi si datë për shqyrtimin e tyre datën 28.02.2023.
5. Seanca e datës 28.02.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit, dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së; si dhe të përfaqësuesit të Bashkisë Durrës, z. Vangjel Martushi, me detyrë Shef i Sektorit Juridik.
6. Gjatë seancës së shqyrtimit, përfaqësuesi i Bashkisë Durrës parashtroi se: *veprimtaritë e referuara në kërkesën nr. 05 të Komisionerit janë në kuadër të inspektimeve në terren të Bashkisë Durrës, pa praninë e Kryetares së Bashkisë, si të tilla ato nuk kanë pasur qëllim informimi dhe janë zhvilluar pa prezencën e mediave. Këto veprimtari Inspektim/ Kontroll janë kryer sipas nenit 23, të Ligjit "Për Vetëqeverisjen Vendore" në lidhje me infrastrukturën dhe*

*shërbimet publike. Përsa i përket kërkesës nr. 08 të Komisionerit, aktivitetet e Bashkisë Durrës janë raportuar në KQZ por kanë pasur karakter jopublik, nuk janë pasqyruar në media, si dhe disa prej tyre nuk janë zhvilluar fare dhe pse janë raportuar. Veprimtaritë e kryera i kategorizoi jopublike, por si ushtrim të funksionit të Kryetarit të Bashkisë. Z. Martushi shprehu se: "Aktivitetet tona i kemi raportuar të gjitha në KQZ, edhe pse nuk i kemi konsideruar si veprimtari publike sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor; ato nuk janë pasqyruar në media. Përkatesisht në dy nga aktivitetet Inspektim/Kontroll, thjesht janë verifikuar punimet në terren. Veprimtaritë e kryera janë në funksion të detyrës së Kryetares të Bashkisë Durrës. Mbi faktin që raportimet janë kryer jo në kohë parashtraj se kemi pasur probleme teknike me aksesin në ndërfaqe dhe nuk kemi shfrytëzuar mënyra të tjera komunikimi me KQZ-në."*

7. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesat nr.05 dhe nr. 08, datë 17.02.2023 të Komisionerit;
  - Vendimin e Komisionerit nr.45, datë 08.02.2023 "Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Durrës, për periudhën 20 janar – 23 janar 2023";
  - Vendim nr. 52, datë 10.2.2023 "Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Durrës, për periudhën 24 janar – 2 shkurt 2023";
  - Shkresën nr. 461 prot., datë 258.01.2023, me objekt "Kërkesë për paraqitje të pretendimeve në procesin administrativ";
  - Ekstraktin e raportimeve nga ndërfaqja e raportimeve e KQZ-së për veprimtaritë:
1. "Mbjellje pemësh dhe shtim i koshave në qytet" raportuar në datë 20.01.2023 me datë zhvillimi të veprimtarisë datën 20.01.2023;
  2. "Vendosja e ndriçimit të ri në rr. 'Haziz Shkupi'" raportuar në datë 21.01.2023, me datë zhvillimi të veprimtarisë datën 21.01.2023;
  3. "Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit në Rajonin 4 Durrës", raportuar më datë 24.01.2023 me datë zhvillimi të veprimtarisë datën 25.01.2023;
  4. "Inspektim/Kontroll në kantierin e zbatimit të infrastrukturës arsimore në Shkollën "Eftali Koci", raportuar në datë 25.01.2023 me datë zhvillimi të veprimtarisë datën 26.01.2023;

5. Inspektim/Kontroll në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike”, raportuar më datë 25.01.2023 me datë zhvillimi të veprimtarisë datën 26.01.2023;
6. “Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit”, raportuar në datë 25.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 26.01.2023;
7. “Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit”, raportuar në datë 25.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 27.01.2023;
8. “Mbrëmje me interpretimin e aktorëve të skenës shqiptare, Kadare në Vargje”, raportuar në datë 25.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 28.01.2023;
9. “Bashkëbisedim për binjakëzim mes dy bashkive”, raportuar në datë 26.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 27.01.2023,.
10. “Inspektim/Kontroll - mirëmbajtja e infrastrukturës së Bashkisë Durrës”, raportuar në datë 26.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 27.01.2023,
11. “Inspektim/Kontroll - mirëmbajtja e infrastrukturës së Bashkisë”, raportuar në datë 26.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 26.01.2023,
12. “Inspektim/Kontroll - mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore në njësinë administrative Rrashbull”, raportuar në datë 28.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 31.01.2023,
13. “Ceremoni e betimit të marrjes së shtetësisë”, raportuar në datë 28.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 28.01.2023,
14. “Nënshkrimi i marrëveshjes për zhvillimin e projektit “Durrës Yacht & Marina” mes Qeverisë Shqiptare, Albanian Seaports Development Agency, Eagle Hills Real Estate”, raportuar në datë 28.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 30.01.2023,
15. “Seminar - Përfshirja e grave në biznes në nivel lokal si pjesë e trajnimit “Gratë e suksesshme””, raportuar në datë 30.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 03.02.2023,
16. “Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit”, raportuar në datë 30.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 03.02.2023,
17. “Inspektim/Kontroll në rikonstrukcionin e hapësirave publike në lagjen 17”, raportuar në datë 31.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 02.02.2023,
18. “Takim në kuadër të projektit “Ëe Are Arberesh””, raportuar në datë 31.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 02.02.2023,

19. “Takim në kuadër të projektit “Ëe Are Arberesh””, raportuar në datë 31.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 03.02.2023,
20. “Mbledhje jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak”, raportuar në datë 31.01.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 03.02.2023,
21. “Inspektim dhe aktivitet ndergjegjësues në spitalin Rajonal Durrës dhe Poliklinikën Qëndrore Durrës”, raportuar në datë 02.02.2023 dhe datë zhvillimi të veprimtarisë datën 03.02.2023.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstatoi:**

1. Kërkesa nr. 05, datë 17.02.2023 ka identifikuar 2 raste raportimesh nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës të kryera në një afat më të shkurtër se afati 5 ditor që kërkon Kodi. Mosrespektimi i afatit 5 ditor nga data e planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë objekt raportimi, e vendos KQZ-në në pamundësi objektive për të luajtur rolin e saj parandalues (kur është rasti), duke e bërë në këtë mënyrë mekanizmin në fjalë të paaplikueshëm.
2. KAS vlereson se raportimi i çdo aktiviteti që zhvillon Bashkia, përfshirë dhe aktivitetet në përmbushje të detyrimeve funksionale (si psh mbledhje e Këshillit Bashkiak), pa analizë dhe vlerësim nëse këto aktivitete plotësojnë kriteret formale që të jetë publike sipas përcaktimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, e dëmton procesin duke krijuar vështirësi për KQZ që të ushtrojë funksionin e vet monitorues, duke rënë në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e ligjit.
3. KAS arrin në konkluzionin se veprimtaritë “Mbjellje pemësh dhe shtim i koshave në qytet” dhe Inspektim/kontrolli për “Vendosjen e ndriçimit të ri në rrugën ‘Haziz Shkupi’” nuk kanë qenë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, dhe janë zhvilluar pa praninë e medias. Për këto arsye, nuk konsiderohen aktivitete publike për të cilat të ekzistojë detyrimi për raportim.
4. Kërkesa nr. 08, datë 17.02.2023 ka identifikuar 19 raste raportimesh nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës të kryera në një afat më të shkurtër se afati 5 ditor që kërkon Kodi. Komisioneri ka kërkuar vendosjen e sanksionit administrativ për 6 nga këto veprimtari, pa i specifikuar ato. Për rastet e tjera, Komisioneri ka preferuar, në diskrecionin e tij, që të mos procedojë me kërkesën për vendosjen e sanksionit.

5. KAS-i konstaton se për veprimtaritë “Mbrëmje me interpretimin e aktorëve të skenës shqiptare, Kadare në Vargje”, “Nënshkrimi i marrëveshjes për zhvillimin e projektit “Durrës Yacht & Marina” mes Qeverisë Shqiptare, Albanian Seaports Development Agency, Eagle Hills Real Estate”, seminarin “Përfshirja e grave në biznes në nivel lokal si pjesë e trajnimit “Gratë e suksesshme”” dhe takimet datave 2 dhe 3 shkurt 2023 në kuadër të projektit “Ëe Are Arberesh” Bashkia Durrës nuk ka qenë institucion organizator. Në tri veprimtaritë e fundit, organizatori nuk ka pasur barrën e raportimit në ndërfaqen e raportimeve, kurse seminari është raportuar si veprimtari jopublike, kur në fakt është veprimtari publike.
6. Veprimtaritë “Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit në Rajonin 4 Durrës”, “Bashkëbisedim për binjakëzim mes dy bashkive”, “Mirëmbajtja e infrastrukturës së Bashkisë” e datës 26.01.2023, “Mirëmbajtja e infrastrukturës së Bashkisë Durrës” e datës 27.01.2023, “Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore në njësinë administrative Rrashbull”, “Ceremoni e betimit të marrjes së shtetësisë”, “Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit” të datës 03.02.2023, “Inspektim/Kontroll në rikonstruksionin e hapësirave publike në lagjen 17” janë raportuar si veprimtari jopublike. Përveç ceremonisë së betimit, e cila për nga natyra e saj është veprimtari publike, për veprimtaritë e tjera KAS-i krijon bindjen se kanë qenë të planifikuara të zhvilloheshin si veprimtari jopublike. Për këto veprimtari nuk ka ekzistuar detyrimi për raportim.
7. Veprimtaria “Mbledhje jashtë radhe e këshillit bashkiak” është veprimtari në ushtrim të detyrave funksionale të këshillit. Në vlerësimin e KAS-it, kjo veprimtari nuk raportohet.
8. Veprimtaritë “Inspektim/Kontroll në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike” e datës 26.01.2023, “Inspektim/Kontroll në kantierin e zbatimit të infrastrukturës arsimore në Shkollën “Eftali Koci”, “Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit”, e datës 26.01.2023, “Inspektim/Kontroll në kantierin e punimeve të objekteve të rindërtimit” e datës 27.01.2023 përbëjnë veprimtari publike dhe janë raportuar si të tilla nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës. Në këto kushte, gjendemi përpara shkeljes së pikës 2 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, duke mos respektuar afatin 5 ditor për raportimin e veprimtarive publike.
9. KAS-i çmon se Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës është “person i ngarkuar me detyra”, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor, për shkak se ai është personi i caktuar përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike. Për pasojë, kërkesa e

Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ është e bazuar ligjërisht. Shkelja e afatit 5 ditor që përcakton pika 2 e nenit 92 formon shkelje të provuar të Kodit, prandaj KAS-i çmon se ajo duhet të pranohet.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS, në seancën e datës 28.01.2023

#### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës nr. 05, datë 17.02.2023 të Komisionerit;
2. Pranimin e kërkesës nr. 08, datë 17.02.2023 të Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj znj. Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës, për shkeljen e afatit sipas pikës 2 të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar;
3. Vendosjen e sanksionit administrativ ndaj znj. Dhurata Gjoka, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës në masën 10 000 (dhjetë mijë) Lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Koli BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>